



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 196 Prot.

Tiranë, më datë 13.06.2024

**VENDIM**  
**Nr. 169, datë 13.06.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.06.2024:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Konceptit të sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit “Objekt hotelerie dhe shërbime 4 kate, me 1 kat nëntokë”, Zvërnec, Bashkia Vlorë”, Brenda Zonës së mbrojtur të Qytetit Antik të Triportit, fshati Zvërnec, Bashkia Vlorë, me aplikues z. Taulant Rama dhe zhvillues **subjekti Algedi 2008 sh.p.k;**
  2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike në kuadër të projektit “Objekt hotelerie dhe shërbime 4 kate, me 1 kat nëntokë”, Zvërnec, Bashkia Vlorë”, Brenda Zonës së Mbrojtur të Qytetit Antik të Triportit, fshati Zvërnec, Bashkia Vlorë, me aplikues z. Taulant Rama dhe zhvillues subjekti Algedi 2008 sh.p.k, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
  3. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitet për shyrtim dhe vendimmarje në KKTKM;
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
  5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Sokol ISMAILI**

